



Sporti

– një start i mirë në jetë

Sporti u jep si të rriturëve ashtu edhe fëmijëve mundësi për të lëvizur, të sfidojnë vetveten dhe njëri-tjetrin si dhe të argëtohen. Të jesh anëtar i një shoqate sportive të jep mundësi të gesh dhe të hysh në një shoqëri të re. Për fëmijë dhe të rinjë ky është një start i mirë në jetë.

Sporti – një zgjedhje e mirë

Ky informacion shpjegon se si funksionon sporti në Suedi dhe se si ti dhe fëmijët e tuaj mund të hyjnë në shoqërinë sportive.

E hapur për të gjithë

Ka afërsisht 20 000 shoqata sportive në Suedi. Një shoqatë sportive është e hapur për të gjithë për t'u anëtarësuar ku mund të ndash përjetimet, gëzimet dhe shoqërinë me të tjerë. Krijimi dhe anëtarësimi në një shoqatë është një e drejtë që mbrohet nga kushtetuta suedeze. Shumë vetë e ndejn veten të gëzuar dhe krenar rreth anëtarësisë së vet por nuk ke nevojë t'u tregosh të tjerëve rreth anëtarësisë nëse ti vet nuk do. Ai /ajo që do të të anëtarsohet në një shoqat duhet t'a deklaroj numrin personal. Kjo është e nevojshme për sigurime, licenca garimi dhe kontribute dhe nuk përdoret në ndonjë kontekst tjetër jashtë sportit. As shteti e as komuna nuk vendosin mbi sportin. Kjo është lëvizja më e madhe popullore në Suedi dhe udhëhiqet nga vet anëtarësia.

Sporti krijon bashkim

Të gjithë janë të mirëseradhur në një shoqatë sportive pavarësisht nëse je djalë apo vajzë, nga cili vend je, nëse je fetar apo jo, çfarë profesioni ke apo ku banon. Në shoqatën sportive të gjithë njerëzit bashkohen rreth një interesi të përbashkët dhe dëshirës për të krijuar diçka të përbashkët. Përveç kësaj gjuha e sportit është internacionale: Një top kërcen njëjtë si në serbishte ashtu edhe në suedishte, një kërcim së gjati është i njëjtë si në svahili ashtu edhe në suedishte. Sporti ngjallë emocione tek shumë njerëz dhe është një temë e përbashkët për të cilën mund të bisedohet.



Puna e shoqatës bëhet në baza vullnetare

Shumica e shoqatave sportive menaxhohen nga personat në baza vullnetare, d.m.th i ndihmojnë shoqatës, disa herë në javë, zakonisht në mbrëmje pa kompensim në të holla. Këta janë zakonisht prindër të fëmijëve që merren me sport në kuadër të shoqatës por mund të jenë edhe persona të tjerë që angazhohen për arsye se e duan sportin dhe shoqatën. Asnjë shoqatë nuk mund të mbijetoj vetëm në bazë të kontributit të disa personave por nganjëherë kërkohet që të gjithë anëtarët, prindërit, të rriturit e tjerë dhe të rinjtë të japin kontributin e tyre sipas mundësive që kanë.

Udhëheqës që motivojnë të tjerët

Sporti i mirë ndërtohet duke pasur udhëheqës dhe trajner që japin udhëzime, motivacion dhe i përkrahin sportistët e rinjë. Përveç kësaj ata janë edhe shembëlltyrë e mirë. Ata kanë një përgjegjësi të madhe dhe shumicën e kohës së vet të lirë u'a kushtojnë fëmijëve të vet dhe fëmijëve e të rinjëve të tjerë.

Sporti i rëndësishëm

Në Suedi mbretëron opinioni se shoqatat sportive janë të rëndësishme. Andaj shumica e tyre marrin ndihma financiare nga shteti dhe komuna. Por kjo ndihmë nuk mjafton për t'i mbuluar shpenzimet për stërvitje, arsimim të trajnerëve, pajisjeve sportive, garat, udhëtimet etj. Andaj anëtarët kanë mundësi të realizojnë të ardhura përmes shitjes së tiketave të lotarisë, shitjes së kafesë, sendiçeve etj. si dhe duke mbledhur tarifat e anëtarësisë.

Anëtarët vendosin

Shoqatat vullnetare janë demokratike. Së paku një herë në vit shoqata duhet të ketë mbledhje vjetore, ku anëtarët, pra ata që e kanë paguar anëtarësinë, diskutojnë gjërat me të cilat do të merret shoqata dhe si të përdoren të hollat e shoqatës. Në mbledhjen vjetore secili anëtar e ka një votë. Aty si anëtar ke mundësi të votosh për ata të cilët do që të zgjedhen në kryesi. Kryesia pastaj e ka përgjegjësinë se si shoqata menaxhohet deri në mbledhjen e ardhshme vjetore. Kryesia përkujdeset poashtu që shoqata e zbaton statutin e shoqatës e cila është rregullorja e përbashkët e anëtarve se si një shoqatë të funksionoj.



Prindërit janë të rëndësishëm në klub

Në mënyrë që viprimtaritë për fëmijë dhe të rinjë të kënë sukses, duhet ndihmesa e prindërve dhe të rriturve tjerë. Kjo d.m.th. që fëmijët kanë nevojë të shoqërohen me vetur deri në një ndeshje të largët ose ne aktivitetët që klubi rregullon ose për më marr para për klubin. Këto kontribute janë të rëndësishme për një klub që mbahet me punë vullnetare.

Eja edhe ti në bashkësinë sportive. Përjeto gëzimin e lëvizjes, lojës dhe garës.



Suedia ka një zgjedhje të madhe të shoqatave sportive

Në Suedi ka shoqata që janë mbi 100 vjetë të vjetra e ka të tjera që janë formuar para ca kohësh. Pavarësisht moshës ato ofrojnë një variacion të madh të sporteve. Këtu ka sporte ekipi dhe sporte individuale si dhe sporte verore e dimërore. Mundësia për të zgjedhur është shumë madhe varësisht se çka i pëlqen fëmijës suaj, varësisht nga qëndrueshmëria, kondicioni, koncentrimi dhe forca. Shumë shoqata ju ofrojnë që të provoni degën sportive dhe ambientin në shoqatë para se t'ju kërkohet pagimi i anëtarisë. Andaj lejo fëmijën tuaj të provoj sportin që qyteti i juaj ju ofron.

